



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe EC MA
NDARYSHE

THIRRJE PËR OFERTË

“Hartim/zhvillim për manual mbi rëndësinë dhe format e zbatimit që QZhQ-ve (SDG) në projektet e realizuara nga komunitatet”

Programi për të drejtat e njeriut, “HumanRightivism”, i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida), ka për qëllim që nëpërmjet shoqërisë civile të përmirësojë të drejtat e njeriut, që janë të natyrshme, origjinale dhe të bazuara në interes të grupit, përmes këtyre tri komponentëve: 1) Të drejtat e njeriut dhe aktivizimi arsimor; 2) Dokumentimi; monitorimi (watchdog) dhe qasja strategjike dhe 3) Të drejtat mjedisore.

EC Ma Ndryshe është njëra nga organizatat përfituese të këtij programi, në kuadër të të cilit shpall këtë thirrje përmes së cilës fton ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të e interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre për **“Hartim/zhvillim për manual mbi rëndësinë dhe format e zbatimit që QZhQ-ve (SDG) në projektet e realizuara nga komunitatet”**.

Dokumenti duhet të përmbajë dhe të trajtojë raportet dhe studimet e gjendjes mjedisore dhe investimeve të bëra nga komunitatet në këtë fushë, duke përfshirë analizën e politikave, strategjive dhe të dhënave përkatëse kombëtare dhe lokale në lidhje me QZhQ-ve (SDG-të) në Kosovë dhe të analizojë zbatimin e këtyre objektivave nga ana e institucioneve komunale duke shërbyer kështu si udhërrëfyes për zbatimin e tyre.

Gjatë hartimit/zhvillimit të dokumentit, pala e angazhuar duhet të bashkëpunojë me autoritetet lokale, departamentet qeveritare dhe organizatat përkatëse për të mbledhur informacione dhe njohuri si dhe të organizojë takime përkatëse për t'i njoftuar për qëllimin e analizës/hulumtimit.

Kriteret për ofertim:

- Oferta duhet të përmbajë dokumentet në vijim: Për ekspertet/grupet e ekspertëve dërgohen vetëm CV-të e personave përgjegjës;
- Çertifikata e regjistrimit të biznesit/ OJQ, Çertifikata e numrit fiskal; Çertifikata e TVSH- së (kompanitë që janë deklaruese të TVSH-së), CV-të e personave që do të angazhohen për realizimin e aktivitetit;
- Oferta duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtër të metodologjisë së hulumtimit/analizës duke ofruar së paku informata mbi dokumentacionin që do të analizohet, palët që do të përfshihen/kontaktohen dhe strukturën e propozuar të dokumentit. Çmimi duhet të përfshijë koston profesionale dhe ato të transportit;
- Pala ofertuese duhet të caktojë një person për kontakt direkt dhe komunikim me EC Ma Ndryshe;

Ofertat duhet të dorëzohen fizikisht në zyret e EC Ma Ndryshe, Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren ose në mënyrë elektronike në info@ecmandryshe.org deri më 27.08.2023, ora 15:00 me shënim: **“Hartim/zhvillim për manual mbi rëndësinë dhe format e zbatimit që QZhQ-ve (SDG) në projektet e realizuara nga komunat”**.

Ofertat që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen.

Për pyetje shtesë rreth kësaj thirrjeje mund të na kontaktoni në: info@ecmandryshe.org deri më 25.08.2023.

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të, nëse këtë e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Vetëm ekspertët /grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të fitues do të informohen/kontaktohen.

OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren ~ Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7, 10000 Prishtinë
www.ecmandryshe.org ~ info@ecmandryshe.org ~ 029-222-771 & 038-224-967